



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit KUVENDI KOMUNAL VITI OE ankues ARLINDI SHPK	Kopje:	Paneli Shqyrtues OSHP
Prej:	Abetare Prebreza – Ekspert Profesional i Prokurimit		
Lënda:	Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me nr. 285/19 të parashtruar nga		
Datë	17.06.2019		

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës 06.06.2019 me nr. 285/19 të parashtruar nga OE “ARLINDI SHPK” Ferizaj lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i lumenjeve dhe prrockave” me nr. të prokurimit VI657-19-016-521, 657-19-2139-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL VITI.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të Ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veproj sipas kërkesave të Nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e Ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KUVENDI KOMUNAL VITI
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – ARLINDI SHPK

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE për “Rregullimi i lumenjeve dhe prrockave” me nr. të prokurimit VI657-19-016-521, 657-19-2139-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal Viti



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	10.06.2019	17.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 06.06.2019 OE “ARLINDI SHPK” Ferizaj, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër Vendimit të AK për dhënie, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i lumenjeve dhe prockave” me nr. të prokurimit VI657-19-016-521, 657-19-2139-5-2-1.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik ankues “ARLINDI SHPK” Ferizaj

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “ARLINDI SHPK” Ferizaj

AK gjatë vlerësimit të këtij tenderi ka bërë shkelje të këyre dispozitave ligjore:

1. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, AK ka bërë shkelje të këyre dispozitave të ligjit Publik neni 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminues
2. AK ka bërë shkelje të këyre dispozitave të ligjit Prokurimit Publik Neni 55
3. AK ka bërë shkelje të këyre dispozitave të ligjit Prokurimit Publik Neni 60
4. AK ka bërë shkelje të këyre dispozitave të ligjit Prokurimit Publik Neni 72

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Ne si OE kemi pranuar përmes platformës elektronike me datën 21.05.2019 vendimin e AK ku është e bashkangjitur edhe letra standarde për eliminim ku thuhet se ne si OE:

[Tenderi juaj është refuzuar] për këtë arsye: Ju nuk keni plotësuar kërkesat sipas FDT, gjegjësisht nuk keni plotësuar: Ju nuk jeni përgjigjur në ftesën për sqarimin e tenderit me datën 16.05.2019.

Kundërshtojme këtë arsye pasi që AK nuk ka dërguar kërkesë me shkrim në lidhje me këtë as në platformën elektronike e as në postën elektronike e-mail.

Ne si OE po ju bashkangjesim edhe dëshminë në sistemin e-Prokurimi që dëshmon se AK nuk ka dërguar një sqarim të tillë tek ne por vetëm supozon për një gjë të tillë, ku ne si OE jemi me çmim më të lirë të përgjegjshëm.

Me datën 23.05.2019 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pasi që ne nuk kemi marrë as një kërkesë për sqarim nga ana e AK-së.

Kërkesa për sqarim në sistemin elektronik është paraqitur me datën 29.05.2019 ora 11:44, në po të njëjtën datë ne kemi kthyer përgjigje tek autoriteti kontraktues për kërkesën e sqarimit e cila nuk është marrë për bazë pasi që brenda asaj date (29.05.2019) ne kemi pranuar në sistemin elektronik vendimin për refuzim në të kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar.

Kërkojmë nga ana juaj që ti shikoni dokumentat e kompanive: Konz. NNP ATC & RAHOVICA COMERCE si dhe Kompanisë PRO & CO GROUP që sipas AK janë shpallur si të përgjegjshme vetëm e vetëm për të zënë çmimin ku pretendon se jemi jo-normalisht të ulët me 30% sipas matematikave të zyrtarit të prokurimit.

Të bashkangjitura gjeni dëshmitë si dhe e-mail të cilat zyrtari i prokurimit pretendon se ne kemi ndërruar e-mailin e cila gjë nuk qëndron se ne kemi po thuajse dy vite që përdorim po të njëjtin e-mail zyrtar për komunikim si dhe për sistem elektronik, si dhe në Formularin C ka qenë po e njëjta e-mail.

Zyrtari i prokurimit sipas dëshirës të tij mundet të shkruaj në çfarë do e-mail-i mirëpo tek ne arrijn vetëm ajo që ne e kemi zyrtare.

Dëmet materiale

Humbja e besimit dhe imazhit të kompanisë.

Pretendimet ankimore janë të njëjta si në Kërkesën për rishqyrtim.

Procesi i prokurimit

Data e njoftimit për kontratë	12.04.2019
Lloji i procedurës së aplikuar	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar	Purë, vlerë e mesme
Vlera e parashikuar e kontratës	70,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës (N.52)	Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	02.05.2018
Data e hapjes së ofertave	02.05.2018
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave	21.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar	21.05.2019

Signature

Data e Vendimit së AK për dhënie të kontratës	21.05.2019
Data e Kërkesës për rishqyrtim	23.05.2019
Data e Vendimit të AK-së lidhur me Kërkesën për rishqyrtim	29.05.2019

Kriteret për vlerësim

Kërkesat e përshtatshmërisë

- a) Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi përshtatshmerin të ligjit të prokurimit nr. 04L-042, neni 65.....Obligative.
- b) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik , se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tre muajt e fundit para dorëzimit të tenderi.....Obligative. (për fituesin)
- c) Vërtetimin e Gjykatës Ekonomike.. Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që përmbush “kërkesat e përshtatshmërisë” (Të mos jetë më i vjetër se gjashtë muaj nga dorëzimi i tenderit)..... Obligative. (për fituesin)

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- a) Deklarata nën betim, në dosje e vulosur dhe e nënshkruar.
- b) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore - origjinal
- c) Vërtetimin e gjykatës ekonomike -origjinal ose kopje e noterizuar

Përshtatshmëria profesionale

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Çertifikata e Regjistrimit i TVSH-s
3. Regjistrimi i Numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
2. Kopja e certifikatës së TVSH-së
3. Kopja e Numrit fiskal;

Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Kontrata të projekteve për punë të ngjashme hidroteknike, minimum tri kontrata, në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë
2. Staf i tepunesuarve, min 15 puntore Menaxheri i projektit të jetë inxh. diplomuar i Nderimtarisë drejtimi hidroteknik me min, 5 vite përvojë, CV, dipl.noterizuar, referenc, kontrata dhe Gjeodet të diplomuar dhe të licencuar pranohet edhe bachelor me min 3 vite përvojë pune CV, dipl.noterizuar, referenc ,kontrat. Vendimi për caktimin e menaxherit lëshuar nga OE
3. Mekanizmi dhe mjetet e punës të ofruar nga OE,
 - Min. një (eskavator) me zingjir me peshe 23.5 T,
 - Min. një (eskavator) me goma me peshe 8.8T,
 - Min. një (damper) për bartjen e materialit me peshe 3.1 T,
 - Min. një makine hidraulike për shpim për pastrim të kanaleve të mbyllura gypave me peshe 1.65 T ,
 - Min. dy kamiona kipper dy dyersh me peshe bartese min 10 m3
 - Dy kamioneta për bartjen e puntoreve
4. OE të jete i pajisur me ISO Standarde për ndërtimtari me PAS 99 2012 dhe një puntore të standardizuar në menagjim të kualitetit të punimeve

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- 1.Lista e projekteve të ngjashme për tri vitet e shkuara, e vëlosur dhe e nënshkruar nga OE ,të ofroj dëshmi për minimum tri kontrateve bashkangjitur referencat ose pranimet teknik , si dhe një kontratë të vetme për punë hidroteknike
- 2.Lista e Stafit të punësuarve, MIN.15, të nënshkruar nga kompania, me kontratë ose parakontratë. NJE Menaxher i projektit të jetë inxh. I dip.indertimtarisë-hidroteknik-diplomë universitare, prej datës së diplomimit 5 vite përvojë,CV, kontratë, dipl.noterizuar , Vendimi për caktimin e menaxherit të lëshuar OE.Inxh bach. i ndertimtarisë hidroteknik, gjeodet të licencuar.
3. Lista e pajisjeve dhe mekanizimit të OE ,të vëlosura dhe të nënshkruara të dëshmuar me librezë regjistrimi ose dëdë mbi pronesinë ose Marrvëshjen mbi marrjen me shfrytezim me qira.
- 4.Të ofroj si dëshmi kopje të Iso standardeve të noterizuara.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi (€)	Vërejtje
1	Grup i OE N.N.P. ATC COMSH.P.K.; N.T. RAHOVICA COMERCE	Kaqanik	2,039.00	Jo
2	PRO & CO GROUP SH.P.K.	Klllokot	492.10	Jo
3	Grup i OE VIZIONI BD SH.P.K.; KUSHTRIMI NM SH.P.K.	Viti	689.90	Jo
4	Grup i OE ARLINDI SHPK; INFRA-PLUS SH.P.K.	Ferizaj	1,209.50	Jo
5	HAJRUSHI SH.P.K.	Viti	509.30	Jo
6	N.N.P.T. ENGINEERING	Viti	94,377.00	Jo
7	EURO PROJECT SH.P.K.	Skënderaj	70,451.80	Jo

Komisioni vlerësues pranë AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

Mifail Azizi

Habib Halili

Xhelal Hoxha

Raporti i komisionit vlerësues

Grup i OE N.N.P. ATC COMSH.P.K.; N.T. RAHOVICA COMERCE - çmimi njësi i ofruar është 2,039.00, ndërsa pas kalkulimit me sasitë e përafërta oferta ka çmimin 140,854.00;; OE i pasuksesshëm.

PRO & CO GROUP SH.P.K. - çmimi njësi i ofruar është 492.10, ndërsa pas kalkulimit me sasitë e përafërta oferta ka çmimin 103,989.60;; OE i pasuksesshëm.

Grup i OE VIZIONI BD SH.P.K.; KUSHTRIMI NM SH.P.K. - çmimi njësi i ofruar është 689.90, ndërsa pas kalkulimit me sasitë e përafërta oferta ka çmimin 68,687.00.

Grup i OE ARLINDI SHPK; INFRA-PLUS SH.P.K. - çmimi njësi i ofruar është 1,209.50, ndërsa pas kalkulimit me sasitë e përafërta oferta ka çmimin 58,990.00;; Oferta është refuzuar për shkak të çmimit jo normalisht të ulët. Kemi kërkuar sqarime nga OE me datën 16.05.2019, nuk është përgjigjur. oferta e tij refuzohet edhe sipas Formularit B.57;; OE i eliminuar.

HAJRUSHI SH.P.K. - çmimi njësi i ofruar është 509.30, ndërsa pas kalkulimit me sasitë e përafërta oferta ka çmimin 113,611.50;; Kontratë të projekteve për punë të ngjashme hidroteknike, minimum tri kontratë, në tri

vitet e fundit, nga data e publikimit te njoftimit per kontrate – Jo;; OE te jete i pajisur me ISO Standarde per ndertimtari me PAS 99 2012 dhe nje puntore te standardizuar ne menagjim te kualitetit te punimeve – Jo;; OE i eliminuar.

N.N.P.T. ENGINEERING - Sigurimi i tenderit në pajtueshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit – Jo;; OE i eliminuar.

EURO PROJECT SH.P.K. - OE i pasuksesshëm

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues.

Emri i OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi (€)
Grup i OE VIZIONI BD SH.P.K.; KUSHTRIMI NM SH.P.K.	Viti	68,687.00
EURO PROJECT SH.P.K.	Skënderaj	70,451.80
PRO & CO GROUP SH.P.K.	Klllokot	103,989.60
Grup i OE N.N.P. ATC COMSH.P.K.; N.T. RAHOVICA COMERCE	Kaqanik	140,854.00

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave rekomandon për fitues OE Grup i OE VIZIONI BD SH.P.K.; KUSHTRIMI NM SH.P.K. me çmim prej 68,687.00 €.

Raporti i vlerësimit është i nënshkruar nga tre anëtarët e komisionit për vlerësim dhe nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “ARLINDI SHPK” Ferizaj

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 7, Eksperti sqaron se AK ka bërë shkelje të këtij neni pasi që nuk ka trajtuar të gjithë OE ofertues njësoj.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi që AK ka përcaktuar në dosje të tenderit si kriter për dhënie të tenderit Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

- Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se ka bërë shkelje të nenit 55 dhe 72 të LPP se AK ka dërguar Letër standarde për sqarim të tenderit me datë 16.05.2019 dhe se OE ankues nuk është përgjigjur në të, Eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit të projektit sqaron se me datë 16.05.2019 AK ka dërguar e-mail tek OE ankues tek “arlindishpk@hotmail.com” për “Letër standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët” ku në të thuhet që “Informatat e kërkuara duhet të pranohen me shkrim, në adresën e lartë shënuar brenda 2 ditësh nga data e kësaj kërkesë. Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderit juaj do të refuzohet”.

- Po ashtu, Eksperti sqaron se në Formularin për dorëzimin e tenderit dhe në dokumentin me titull “Lista e OE të interesuar”, listë kjo që e gjeneron platforma e E-Prokurimit për këtë OE është e shkruar e-mail adresa “arlindishpk1@hotmail.com”, pra është shkruar e-mail adresë ndryshe nga ajo që AK ka dërguar dhe shton se sipas nenit 39.8 të RROUPP “AK duhet ti dërgoj OE “Kërkesë për sqarim të tenderit” përmes sistemit të prokurimit elektronik dhe OE duhet të dorëzoj përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik” andaj AK nuk është dashur që të kërkoj sqarime nga OE përmes postës elektronike por

vetëm përmes platformës së E-Prokurimit dhe të sigurohet nëse e-mail adresa është e saktë, nëse do të ishte në fuqi RROUPP paraprak sipas të cilit është lejuar që sqarimet të bëhen edhe përmes e-mail-it.

- Më pas, Eksperti sqaron se pas pranimit të letrës standarde mbi tenderuesin e eliminuar, OE ankues ka bërë "Kërkesë për rishqyrtim" tek AK përmes platformës së E-Prokurimit. Më pas, me datë 27.05.2019 AK ka shkruar e-mail tek "arlindishpk@hotmail.com" ku thuhet që "AK bazuar në nenin 108/A, pika 6 ka bërë shtyerjen e afatit të shqyrtimit të ankesës" dhe të njëjtën e ka dërguar edhe me datë 29.05.2019. Në Vendimin e Kërkesës për rishqyrtim thuhet që "AK ka vepruar konform LPP-s nenit 61 mbi çmimin jo-normalisht të ulët dhe bazuar në Formularin B57, Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët neni 3.1; 3.2; 3.3. Andaj, OE ankues nuk ka dëshmi, përkundër që ka qenë i njoftuar me kërkesën tonë për sqarim, por ai nuk ka shpreh interesim, për çka është deklaruar vetë". Me datë 29.05.2019, OE ankues ka dërguar përmes E-Prokurimit tek AK dokumentin e skanuar të nënshkruar dhe vulosur me emërtim "Përgjigje ne kerkesen per sqarim" me titull "Përgjigje" ku ndër të tjera thuhet "Sa i përket çmimeve të furnizimit ne po u bashkangjesim dëshmitë edhe ofertat të cilat i kemi prej prodhuesve të betonit, armaturës dhe zhavorit me çmime që na furnizojnë ndërsa sa i përket gërmimit dhe pastrimit të kanalit i kryejm me mjetet tona që i kemi në dispozicion dhe çmimet janë shumë më të arsyeshme në treg. Me çmimin që ne kemi ofruar për pozicion ne ju sigurojmë që me po atë çmim do të bëjmë punën e duhur me cilësi dhe sasi të kërkuar" dhe OE ka bashkangjitur 4 fatura të ndryshme për armaturë, beton, beton pompë.

- Ndër të tjera, OE ankues së bashku me ankesë ka ofruar edhe komunikimin përmes postës elektronike që ka zhvilluar me AK, ku AK me datë 27.05.2019 i dërgon e-mail OE ku thuhet "ka ardh një Kërkesë për rishqyrtim ne email por në sistem nuk keni vendos asgjë, nuk po e shof me shkarkue, përcjellma ne e-mail" e më pas OE ankues në po këtë datë 27.05.2019 i dërgon Kërkesën për rishqyrtim AK ku thuhet " edhe në sistem është e ngarkuar por nuk e dim pse nuk mund ta shkarkoni". Pas kësaj, me datë 29.05 nga AK është dërguar tek OE ankues teksti "Une e vertetova kjo ka qene adresa juaj, ju e keni ndrrue dhe nuk ka keni njoftue. Por ju keni qen te njoftuar me goje, nuk keni shpreh interesim per projektin", e në po këtë datë OE kthen tekstin "Me vejn keq zotri po ne kemi vetem kete email zyrtare qe kemi qasje dhe e perdorim mund te shikosh edhe ne dosjet qe ne i dorezojme e keni ne formularin C", e më pas në po këtë datë AK shkruan "Ju keni dy e-maila" e më pas OE shkruan "shikoj edhe njehere e-mail-at qe ju i keni derguar dhe krahasoj me e-mail qe ne e posedojme dhe qe kemi qasje ne E-Prokurimi sepse ai e-mail nuk perputhen me e-mail tone!", pra është paska konfuze.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

- Në lidhje me atë që OE ankues ka thënë që ti shikoj dokumentet e ofruara nga OE NNP ATC & RAHOVICA COMERCE, edhe pse nuk është saktësuar se cilat dokumente, Eksperti sqaron se oferta nuk është plotësisht e përgjegjshme dhe sqaron si në vijim:

1. OE ka ofruar Formularin për dorëzim të tenderit, Listën e çmimeve, Marrëveshjet për theksimin e grupit, Planin dinamik të kryerjes së punimeve dhe Sigurimin e tenderit siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë;
2. OE ka ofruar në ofertën e tij të gjitha dokumentet e kërkuara për kërkesat e përshtatshmërisë për të dy anëtarët e grupit;
3. OE ka ofruar në ofertën e tij të gjitha dokumentet e kërkuara për kërkesat e përshtatshmërisë profesionale për anëtarin e grupit RAHOVICA COMERCE dhe për anëtarin e grupin ATC COM ka ofruar dokumentet e kërkuara përpos certifikatën e TVSH;
4. OE ka ofruar në ofertën e tij këto dokumente për kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional:
 - 4.1. ka ofruar listën e projekteve të nënshkruar dhe vulosur, referencat dhe pranimet teknike dhe kontratën e kërkuar për punë hidroteknike e cila përmban vetëm faqen e parë dhe faqen e nënshkrimeve,
 - 4.2. listën e stafit me mbi 15 persona për të cilat ka ofruar kontrata të nënshkruara nga të dy palët siç është kërkuar;; për menaxher ka ofruar inxhinierin Ilaz Muaxheri për të cilin ka ofruar diplomën me datë diplomimi 28.09.2005 e cila vetëm është vërtetuar në komunë dhe është e panoterizuar, vendimin për projekt menaxher,

kontratën e nënshkruar nga të dy palët, CV dhe dy referenca në të cilat nuk shkruan përvoja e angazhimit por vetëm projektet në të cilat është angazhuar;; për gjeodet ka ofruar Liridon Sejdiu për të cilin ka ofruar diplomën e noterizuar me datë diplomimi 20.12.2011, licencën, kontratën e punës të nënshkruar nga të dy palët, CV dhe nuk ka ofruar referencën e kërkuar (kjo kërkesë e kapacitetit teknik dhe profesional nuk është e njëjtë me dëshminë, është kërkuar “Stafi i tepunesuarve, min 15 puntore Menaxheri i projektit të jetë inxh. diplomuar i Ndertimtarise drejtimi hidroteknik me min, 5 vite përvojë, CV, dipl.noterizuar, referenc, kontrata dhe Gjeodet te diplomuar dhe te licencuar pranohet edhe bachelor me min 3 vite pervoje pune CV, dipl.noterizuar, referenc ,kontrat. Vendimi per caktimin e menaxherit leshuar nga OE” dhe si dëshmi “Lista e Stafit te punesuarve, min. 15, te nenshkruar nga kompania, me kontrata ose parakontrata. nje Menaxher i projektit të jetë inxh. I dip.indertimtarise-hidroteknik-diplomë universitare, prej datës së diplomimit 5 vite përvojë, CV, kontrata, dipl.noterizuar , Vendimi per caktimin e menaxherit e leshuar OE. Inxh bach. i ndertimtarise hidroteknik, gjeodet te licencuar”, pra nuk është saktësuar cilat dokumente duhet ofruar për gjeodetin e kërkuar),

4.3. për anëtarin e grupit RAHOVICA ka ofruar listën e mjeteve të nënshkruar dhe vulosur mirëpo në të nuk shkruan se posedon dy kamioneta, ka ofruar dëshmitë e kërkuara mirëpo nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara për dy kamioneta si dhe për anëtarin e grupit ATC COM ka ofruar listën të nënshkruar dhe vulosur dhe në të shkruan se ka një kamionetë mirëpo nuk ka ofruar dëshminë e kërkuar,

4.4. ka ofruar ISO standardin e noterizuar mirëpo nuk ka ofruar një dhe një puntore të standardizuar në menagjim të kualitetit të punimeve – ka ofruar një kontratë pune të nënshkruar nga të dy palët për titullin “Menaxher i repartit punues” (kjo kërkesë e kapacitetit teknik dhe profesional nuk është e njëjtë me dëshminë, është kërkuar “OE te jete i pajisur me ISO Standarde per ndertimtari me PAS 99 2012 dhe një puntore te standardizuar ne menagjim te kualitetit te punimeve” dhe si dëshmi “Te ofroj si dëshmi kopje te Iso standardeve te noterizuara”)

- Në lidhje me atë që OE ankues ka thënë që ti shikoj dokumentet e ofruara nga OE PRO & CO GROUP, edhe pse nuk është saktësuar se cilat dokumente, Eksperti sqaron se oferta nuk është plotësisht e përgjegjshme dhe sqaron si në vijim:

1. OE ka ofruar Formularin për dorëzim të tenderit, Listën e çmimeve, Planin dinamik të kryerjes së punimeve dhe Sigurimin e tenderit siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë;

2. OE ka ofruar në ofertën e tij të gjitha dokumentet e kërkuara për kërkesat e përshtatshmërisë;

3. OE ka ofruar në ofertën e tij të gjitha dokumentet e kërkuara për kërkesat e përshtatshmërisë profesionale;

4. OE ka ofruar në ofertën e tij këto dokumente për kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional:

4.1. ka ofruar listën e projekteve të nënshkruar dhe vulosur, referencat dhe pranimet teknike mirëpo nuk ka ofruar kontratën e kërkuar për punë hidroteknike,

4.2. listën e stafit me mbi 19 persona për të cilat nuk ka ofruar kontratat ose parakontratat e kërkuara;; për menaxher ka ofruar inxhinierin Lavdim Osmanaj për të cilin ka ofruar diplomën me datë diplomimi 08.11.2005 e cila është e noterizuar, vendimin për projekt menaxher, kontratën e nënshkruar nga të dy palët, CV dhe dy referenca në të cilat nuk shkruan saktësisht përvoja e angazhimit por vetëm projektet në të cilat është angazhuar;; për gjeodet ka ofruar Fisnik Ismaili për të cilin ka ofruar diplomën e noterizuar me datë diplomimi 20.12.2011, licencën, kontratën e punës të nënshkruar nga të dy palët, CV dhe nuk ka ofruar referencën e kërkuar (kjo kërkesë e kapacitetit teknik dhe profesional nuk është e njëjtë me dëshminë, është kërkuar “Stafi i tepunesuarve, min 15 puntore Menaxheri i projektit të jetë inxh. diplomuar i Ndertimtarise drejtimi hidroteknik me min, 5 vite përvojë, CV, dipl.noterizuar, referenc, kontrata dhe Gjeodet te diplomuar dhe te licencuar pranohet edhe bachelor me min 3 vite pervoje pune CV, dipl.noterizuar, referenc ,kontrat. Vendimi per caktimin e menaxherit leshuar nga OE” dhe si dëshmi “Lista e Stafit te punesuarve, MIN. 15, te nenshkruar nga kompania, me kontrata ose parakontrata. NJE Menaxher i projektit të jetë inxh. I dip.indertimtarise-hidroteknik-diplomë universitare, prej datës së diplomimit 5 vite përvojë, CV, kontrata, dipl.noterizuar , Vendimi per caktimin e menaxherit e leshuar OE. Inxh bach. i ndertimtarise hidroteknik, gjeodet te licencuar”, pra nuk është saktësuar cilat dokumente duhet ofruar për gjeodetin e kërkuar);

4.3. ka ofruar listën e mjeteve të nënshkruar dhe vulosur, ka ofruar dëshmitë e kërkuara për to;

4.4. ka ofruar ISO standardin e panoterizuar mirëpo nuk ka ofruar një dhe një puntore të standardizuar në menagjim të kualitetit të punimeve (kjo kërkesë e kapacitetit teknik dhe profesional nuk është e njëjtë me dëshminë, është kërkuar “OE të jete i pajisur me ISO Standarde për ndertimtari me PAS 99 2012 dhe një puntore të standardizuar në menagjim të kualitetit të punimeve” dhe si dëshmi “Te ofroj si dëshmi kopje të ISO standardeve të noterizuara”).

Mendimi i Ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjen në pretendimet e sipërpërmendur nr. 1 deri nr. 4) dhe të anulohet Vendimi i AK për dhënie dhe lënda të kthehet në ri vlerësim.